



Mirë se vini përsëri në Shkollë!

Të dashura Familje dhe Kolegë,

Mirë se vini përsëri! Jam shumë e gëzuar që po fillojmë vitin shkollor 2025-26, dhe shpresoj që edhe ju të jeni po aq të gëzuar. Si një edukatore dhe prind, kam përjetuar shumë “ditë të para shkolle”—por kjo ka një kuptim të veçantë për mua, sepse është dita ime e parë si Kancelare. Komuniteti ynë ka shumë për të arritur këtë vit, dhe mezi pres të nisim.

Së pari, do të vazhdojmë të zgjerojmë nismat tona kryesore: NYC Reads, NYC Solves, Student Pathways dhe NYCPS Cares. NYC Reads (NYC Lexon) dhe NYC Solves (NYC Zgjidh), që rikrijojnë mënyrën e mësimdhënies së leximit dhe matematikës, po shtrihen në 186 shkolla shtesë, dhe programi ynë FutureReadyNYC, që ofron rrugë karriere me kërkesë të lartë për nxënësit e shkollave të mesme, do të zgjerohet në 50 shkolla të tjera. NYCPS Cares (NYCPS Kujdeset), nisma jonë më e re, ka të bëjë me krijimin e një kulture kujdesi në komunitetet tona; si pjesë e kësaj pune, kemi nisur fushata të drejtuara nga nxënësit kundër ngacmimeve e bullizmit dhe kundër përdorimit të cigareve elektronike, si edhe një program të quajtur Family Connectors

(Lidhësit e Familjeve), ku anëtarë të familjeve dhe vullnetarë nga komuniteti ndihmojnë familje të tjera për të pasur qasje në burimet e qytetit.

Këto nisma tashmë po japin rezultate—mjafton të shohim rezultatet e provimeve shtetërore 2025, të cilat tregojnë përparime premtuese si në lexim, ashtu edhe në matematikë. Përqindja e nxënësve që dolën “proficient (në nivelin e aftësisë)” në klasat 3-8 u rrit me 7.2 pikë në lexim dhe 3.5 pikë në matematikë, duke sjellë shkallët tona më të larta të aftësisë në këto lëndë që prej vitit 2012. Jam jashtëzakonisht krenare për nxënësit, stafin dhe familjet tona, puna dhe përkushtimi i të cilëve pasqyrohet drejtpërdrejt në këto rezultate. Sigurisht, kemi më shumë për të bërë, por këto përmirësime tregojnë që jemi në rrugën e duhur.

Këtë vit, do të ndërtojmë mbi këtë përparim duke i dhënë rëndësi të veçantë kureshtjes intelektuale dhe rreptësisë akademike, duke mbushur klasat tona me diskutime të pasura, të menduar të thellë dhe shumë momente “Aha!”. Po ashtu po zbatojmë ligjin e ri të shtetit që ndalon përdorimin nga nxënësit të pajisjeve personale me qasje në internet gjatë ditës së shkollës, gjë që do të ndihmojë të minimizohen shpërqendrimet në mënyrë që nxënësit të angazhohen plotësisht. Nxitja e dashurisë së nxënësve për të mësuarin është një përbërës kyç në përmbushjen e misionit tonë: t’i pajisim ata me dije, aftësi dhe besim për të pasur sukses në karrierat dhe komunitetet e tyre.

Jam shumë e emocionuar që po e nisim këtë udhëtim së bashku me ju si partnerët e mi. Faleminderit stafit tonë, familjeve dhe drejtuesve prindërorë, dhe gjithë komunitetit të Shkollave Publike të Qytetit të Nju Jorkut (NYCPS) për përkushtimin ndaj nxënësve tanë. Gëzuar ditën e parë të shkollës, dhe ja ku nis një vit i mrekullueshëm përpara!

Me respekt,

Melissa Aviles-Ramos
Kancelare

Videoja jonë Kryesore:



Për përkthime, ju lutemi vizitoni faqen tonë në [YouTube](#).

Për të aksesuar titrat e përkthyer: Klikoni mbi ikonën “CC”. Klikoni mbi ikonën “Settings (Cilësimet)” dhe zgjidhni “Subtitles/CC (Titrat/CC)”. Zgjidhni “Auto Translate (Përkthim Automatik)” dhe më pas zgjidhni gjuhën tuaj.

Lajmet dhe Burimet e NYCPS:

- Për lajme dhe burime, vizitoni [The Morning Bell](#) dhe ndiqni NYCPS online në [Facebook](#), [Instagram](#), [X](#), dhe [YouTube](#).
- Këtu është [videoja javore](#) nga Kryetari i Bashkisë Eric Adams. Nëse jeni të interesuar të merrni përditësime direkt nga Zyra e Kryetarit të Bashkisë, [ju lutemi klikoni këtu](#).

Familjet e NYCPS: Nëse nuk dëshironi më ta merrni këtë buletin, ju lutemi [çregjistrohuni](#).